

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-007/15

**Prishtinë,
4 maj 2016**

Në çështjen juridike të:

B.S.

Pala ankuese/Parashtruesi i kërkesës

kundër.

H. Ç.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, si Kryetar i Kolegjit, Gjyqtarët Rolandus Bruin dhe Beshir Islami Anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/232/2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA11544), të datës 13 Mars 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 4 Maj 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga B. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/232/2014, e datës 13 Mars 2014, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/232/2014, e datës 13 Mars 2014, vërtetohet në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA11544.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 Shtator 2006, B. S.(tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP), me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e lokalit afarist me sipërfaqe prej 25 metra katrorë që gjendet në ngastrën kadastrale Nr. 3883 Komuna kadastrale Prizren. Pala ankuese ka sqaruar se familja e tij kanë qenë pronarë të kahmotshëm të kesaj palujtshmerie që e kanë trashëguar pas vdekjes së babait. Prona në vitin 1959 ishte nacionalizuar nga autoriteti i atëhershëm dhe më vonë i ishte ndarë D. D. Momentalisht prona është në shfrytëzim të H.Ç. dhe e njeta është shendrruar në Kolexh privat
2. Bashkë me kërkesën e tij, pala ankuese ka paraqitur në AKP :
 - kopjen e vendimit mbi trashigiminë Nr. 123/56 nga Gjykata e Rrethit të Prizrenit në të cilin shpallën trashigimtarë të palujtshmerisë N. S. (nëna e parashtrusi të ankesës) B.S.(parashtruesit i ankesës) dhe Z. S. (vella i parashtruesit të kërkesës);
 - Kërkesën për nacionalizim dt. 10 Maj 1959 drejtuar autoritetit administrativ për nacionalizim;
 - Kopje e padisë C.47/2000 drejtuar Gjykatës komunale në Prizren për kthimin e posedimit të palujtshmerisë;
 - Aktgjykim i Gjykatës Komunale në Prizren P.br. 348/95 i datës 04.06.1998 jo relevant për pronën e kërkuar;
 - Përgjigje nga Zyra e Prokurorit të Shtetit datë 23.10.2012;
 - Aktgjykim i Gjykatës Supreme Ushtarake jo relevant për pronën e kërkuar;
 - Kopje e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të Komisionit për Kërkesa pronësore dhe Banesore (HPCC);
 - Aktvendim i Gjykatës Komunale në Prizren mbi pezullimin e procedurës për 180 ditë;
 - Vërtetimin Nr. 023-1498/05 12 2001 lëshuar nga Drejtoria për Pronësi, Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prizrenit që dëshmon se prona e kërkuar që nga viti 1957 ka qenë e evidduar në emër të familjes S.kurse me 12.11.1974 prona është regjistruar në emër të D. D.;
 - Marreveshje në mes të trashigimtareve të tjerë dhe B. S. që ai t'i përfaqësoi në lidhje me këtë çështje;

- Konkluzion i datës 12.02.2000 me nr. 462-8 me të cilin parashtruesi B. S. nuk bie në kompetence të organeve administrative;
 - Kërkesë drejtuar Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut;
 - Një seri dokumentash, përmbledhje artikujsh të shtypit, derguar institucioneve, individve dhe OJQ-ve në Kosovë dhe jashtë Kosovës por pa relevancë për çështjen;
3. Më 30 Mars 2010 është bërë njoftimi i kërkesës. Sipas raportit të notifikimit prona e kërkuar është gjetur se ishte shtëpi banimi. Me 8 Tetor 2013 është konstatuar se prona është identifikuar sakt në bazë të GPS koordinatave dhe se kohën e vizitës objekti është gjetur në përdorim nga H. Ç., i cili ishte i pranishëm në pronë, me ç'rast ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje dhe ka deklaruar se kërkon të drejtën pronësore mbi këtë pronë.
 4. Më 25 Tetor 2013 pala përgjegjëse ka paraqitur në AKP përgjigjen në kërkesë me të cilën ai pretendon të drejtën ligjore mbi pronën. Ai ka deklaruar se pronën e ka blerë prej D.D. dhe se sipas shenimeve kadastrale ai ka blerë ngastrat 3882 dhe 3884 ku ngastra 3883 i është bashkangjitur ngastrës 388
 5. Në mbështetje të përgjigjes ai ka parashtruar
 - kontratën e shitblerjës Leg. Nr. 1640/2007 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren me të cilën ai e kishte blerë pronën nga D. D.;
 - Kopjen e planit datë 2 Shkurt 1992 për ngastrat 3882 dhe 3884 ku sipas deklarimit të palës përgjegjëse dhe autoriteteve të kadastrit ngastra 3883 i është bashkangjitur ngastrës 3882;
 - Kopje e listës poseduese 3137 e datës 12 Korrik 1994 me të cilën deshmohet se D.; D. është pronar i 1/1 ingastrave 3883 dhe 3883;
 - Deklartatën e datës 24 tetor 2015;
 - Protokollin i dorëzimit të çelësave i dt. 16.05.2005 që dëshmon se pas kërkesës së D. D. në ish Drejtoratin për Kërkesa pronësore dhe Banesore.

Gjykata Supreme ka gjetur Vendimin HPCC/D/79/2003, të datës 23.06.2003, në ëeb faqen e AKP-së. Në këtë Vendim KÇPB ka vërtetuar se D. D. ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore në pronën e kërkuar dhe ka urdhëruar kthimin e posedimit, i cili është zbatuar sipas Kërkesës DS200539
 6. Më 13 Mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/C/232/2014 (tani e tutje: vendimi i KKPK-së) ka hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 31), KKPK-ja nënvizoi se pala ankuese nuk ka arritur të tregojë se kërkesa e tij përfshin rrethana që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose që janë pasojë i konfliktit të viteve 1998-99, si dhe të tregojë se ishte në posedim të pronës.
 7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 8 Korrik 2014. Më 16 Korrik 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

8. Vendimi i njëjtë i është dorëzuar palës përgjegjëse H.Ç. më 14 Janar 2014. Kopja e ankesës i është dorëzuar Palës Përgjegjëse në kërkesë dhe se me 9 mars 2014 ai është përgjigjur në ankesë ku edhe ka thëksuar se se ajo është e pabazuar.

Pretendimet e palëve:

9. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës ta prish vendimin e KKPK-së si të nxjerrë me shkelje esenciale të ligjit procedural, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të pasaktë të gjendjës faktike. Ai pretendon se Ligji bazik i AKP-së është në kundërshtim m ligjet në Kosovë dhe se duhet të përfshijë edhe periudhën para vitit 1998-99 duke u marrë edhe me çështjet e nacionalizimit siç është edhe rasti i familjës së tij. Prona i është marrë me arbitraritet dhe se ajo duhet kthyer. Ai konsideron se rindraja e pronës tek D. D. është bërë në mënyrë te paligjëshme dhe se edhe shitja tek shfrytëzuesi momental është e paligjshme.

Arsyetimi ligjor:

10. Ankesa kundër vendimit të KKPK-se është dorëzuar brenda 30 ditëve nga momenti që AKP i ka dorëzuar vendimin palës ankuese, ashtu siç parashikohet në Seksionin 12.1 të Rregullores së UNMIK 2006/50 Mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-79 është e pranueshme.
11. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve rezulton se ankesa është e pa bazuar
12. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vendimi i apeluar i KKPK-së është i plotë dhe gjendja faktike e tij është vërtetuar drejt dhe mbi këtë bazë si ligji material ashtu edhe ai procedural janë zbatuar drejt. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
13. Pala ankuese pretendon se ka pas të drejtë pronësore dhe se e njëjta i është marrë me veprim diskriminues dhe joligjor në vitin 1959. Ai paraqet kundërshtimin e tij ndaj sistemit gjyqësorë, Qeverisë dhe autoriteteve të instaluar nga Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara UNMIK dhe tani Qeverisë së Kosovës. Ai kërkon që të përfshihet edhe kthimi i pronave që janë humbur si pasojë e diskriminimit nga pushteti i atëhershëm edhe pse mandati i AKP-së është i kufizuar me ligj.
14. Për të realizuar të drejtën e tij ai i është drejtuar Institucioneve gjyqësore, qeveritare dhe OJQ-ve të ndryshme, Gjykatës europiane të të drejtave të njeriut dhe personaliteteve publike të Kosovës dhe jashtë saj.
15. Në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, *“Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t’i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura*

me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

(a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshëm private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe

(b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

Ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore”.

16. Asnjëri nga dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese nuk vërteton se pala ankuese posedonte pronën e kërkuar apo kishte ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar para ose gjatë konfliktit. Siç ka vërtetuar AKP-ja, pala ankuese në mbështetje të kërkesës së tij ka dorëzuar vendimin mbi trashigiminë i vitit 1956 dhe deshminë e nacionalizimit të vitit 1959. Pala ankuese nuk e mohon se që prej vitit 1959 ai dhe familja e tij nuk kanë qenë në posedim të pronës.
17. Nga ana tjetër pala përgjegjëse ka paraqitur dokumenta që dëshmojnë se prona e kërkuar ishte e D. D. i cili e kishte humbur posedimin si pasojë e konfliktit dhe kishte parashtruar Kërkesë në ish Drejtoratin për Kërkesa pronësore e banesore. Pas procedimit Komisioni i Kërkesave Pronësore e Banësore kishte gjetur se pronari i mëparshëm kishte dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe ishte urdheruar që poseimi t'i kthehej.
18. Mandati i AKP-së është të shqyrtohen lëndët “që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me të ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”. Kjo do të thotë se fushëveprimi i ekzaminimit të AKP-së është verifikimi i këtyre elementeve: kush ishte në posedim të pronës së kërkuar para 27 shkurtit 1998, kush është në posedim të saj tani, kur dhe për çfarë arsye është humbur posedimi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Formulimi i nenit 3.1 “*të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur*” nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të humbjes së posedimit dhe konfliktit të armatosur ose lidhjen e ngushtë të shkakut dhe pasojës e cila në lëndën konkrete mungon.
19. Kjo e bën Gjykatën Supreme të arrijë në përfundim se çështja e kërkesës bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe ankesa e palës ankuese të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i apeluar i KKPK-së të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar le Ligjin nr. 03/L-079.

Konstatim

20. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195, paragrafit 1(d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it